



Dr. Rudina Thanasi

DERMATOLOG-VENEROLOG

NJOLLAT KAFE, CFARE JANE DHE SI TRAJTOHEN?

Nje nga shqetesimet kryesore te fillimit te veres jane njollat kafe ne fytyre. Jo rralle ato shkaktojne pasiguri dhe mbyllje ne vetvete. Ne raste serioze edhe depresione te thella, deri ne tentativa vetvrasjeje.

Por cfare jane njollat kafe?

Njollat kafe jane ato qe ne mjeksi quhen Melasem. Melasma eshte nje c'rregullim pigmentimi i perkohshem ose kronik.

Kur shfaqet melasma?

Melasma shfaqet gjate periudhes se veres dhe zbehet ne dimer.

Kush ben melasma?

Mosha- Te rinjte ne moshen me aktive, te shendetshem 20-40 vjec, rralle perpara pubertetit, por mund te shfaqet edhe mbas te 50-tave.

Sexi- melasma kryesisht prek femrat 75% - 88 % por nuk i fal as meshkujt.

Lloji i lekures- Zakonisht shfaqet ne lekurat kafe dhe te erreta. Shume rralle prek lekurat e celura. E zakoneshme edhe ne pre-menopauze.

Zonat e preferences- Balli, faqet, hunda, mbibuze, por dhe ne zonat e tjera te trupit sidomos tek personat qe ekspozohen per kohe te gjate ne djell.

Pasi shfaqet melasma per sa kohe qendron?

Ne rastin e shfaqjes gjate shtatezanise si vecanti, qendron per disa muaj deri ne nje vite. Por njehere qe eshte shfaqur ka predispozite nga 6- 8 vjet . Rezistente jane ato qe prodhohen nga produktet kosmetike apo rastet qe shoqerohen me semundje te tjera. Ka edhe forma qe kane predispozite te perhershme .

Si trajtohet melasma?

Evitohet ekspozimi ne djell. Krem mbrojtës SPF 30+ jo vetem me filtra kimik por edhe fizike, gjate gjithë vitit. Pergatitjet opike, formula individuale per cdo pacient. Disa medikamente dhe suplimente qe merren nga goja me rekomandimin e mjekut. Peeling i thelle kimik apo kirurgjikal dhe ne varesi te arsyes qe shfaqet, detoksifikim dhe riorganizim i ciklit biologjik. Pjesa me e veshtire rezulton ne ruajtjen e rezultatit nga pacienti.

Sa lloje melasma-sh jane?

- Siperfaqesore
- Dermale
- Mikse, lloji me i zakonshem i melasmes.

PYETJET ME TE SHPESHTA PER MELASMEN

A eshte melasma ngjitese?

Nuk eshte: Ngjitese, Infektive, Alergjike, Kancerogjene dhe as nuk perparon ne kancer,

Kush hormon e prodhon melasmen?

Prej hormoneve sexuelle estrogen dhe kryesisht progesterone,

Cfare eshte chloasma ?

Melasma dhe chloasma jane e njejta gje.

Dr.Rudina Thanasi

Dermatolog-Venerolog

Telefon: 0682023331

Adresa: Rr. "MilitoTutulani", Pallati 6 "Albmillenium", shkalla 2, Nr 1.